



Down Syndrome  
Albania

## KOMUNIKATË PËR MEDIA

### 21 MARSI DITA BOTËRORE E SINDROMËS DOWN - FONDACIONI DOWN SYNDROME ALBANIA

Tiranë, 20.03.2020

21 Marsi është Dita Botërore e Sindromës Down, e vëzhguar si e tillë nga Kombet e Bashkuara që prej vitit 2012.

Sipas statistikave të mbledhura nga Shërbimi Social Shtetëror në vitin 2018, në Shqipëri jetojnë 682 persona me sindromën Down, mes 73.000 personave (2020) me aftësi të kufizuara (pa përfshirë invalidët e punës) që jetojnë në Shqipëri.

Në kuadër të kësaj dite e çdo ditë Fondacioni Down Syndrome Albania kërkon të sjellë **në vëmendje të qeverisë dhe ligjvënësve shqiptarë** si dhe iu bën thirrje të gjitha institucioneve shqiptare por dhe partive politike që të kthejnë vëmendjen dhe të punojnë me seriozitet për të përmbushur të drejtat dhe nevojat e personave me aftësi të kufizuara (PAK) në Shqipëri. Shqipëria ka ratifikuar *Konventën e Kombeve të Bashkuara Për Të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara*, dhe ka detyrime konkrete ndaj kësaj konvente.

**Kërkojmë si më poshtë vijon:**

- 1. PLOTËSIM TË KUADRIT LIGJOR DHE LIGJE TË ZBATUESHME QË PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA (PAK) TË MUND T’I GËZOJNË TË DREJTAT E TYRE!**
- 2. NGRITJEN E SHËRBIMEVE PËR PAK NË ÇDO BASHKI!**
- 3. ËSHTË EMERGJENTE QË ORGANIZATAT QË OFROJNË SHËRBIME PËR PAK, TË MBËSHTETEN NË MËNYRË TË QËNDRUESHME NGA BUXHETET E SHTETIT (QËNDROR E LOKAL) TË PAKTËN ME 30% TË BUXHETIT TË NEVOJSHËM VJETOR TË KËTYRE QENDRAVE (TË LICENCUARA).**

Sipas një studimi të UNDP në Shqipëri, gjatë vitit 2020, në 18 bashki të vendit vetëm 1901 persona me aftësi të kufizuara kanë pasur akses në shërbime publike. Nisur nga kjo e dhënë si referencë, po të bëjmë llogaritë për 61 bashki, mund të hamendësojmë se jo më shumë se 6500 PAK kanë akses në shërbime publike në Shqipëri, pra me pak se 1% e PAK (73.000 persona). Ndërkohë po sipas të njëjtit studim të UNDP, rreth 42% e shërbimeve shoqërore në Shqipëri ofrohen nga operatorë jo-publikë (siç janë organizatat e ngritura nga vetë PAK apo prindërit e tyre).



Down Syndrome  
Albania

4. KOMITETI I EKSPERTËVE TË FUSË NË PLANIN KOMBËTAR TË VAKSINIMIT NË GRUP PRIORITAR, PERSONAT ME SINDROMËN DOWN SI GRUP RISKU\* SI DHE STAFET E QENDRAVE PUBLIKE DHE JO PUBLIKE QË OFROJNË SHËRBIME PËR PAK.
5. QEVERA SHQIPTARE TË MBËSHTESË FINANCIARISHT PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA ME NJË VLERË MONETARE TË BARABARTË ME SHUMËN E PAGESËS SË AFTËSISË SË KUFIZUAR PËR TË LEHTËSUAR SADOPAK EFEKTET E PANDEMISË NË JETËN E TYRE.

Si çdo vend i botës dhe Shqipëria po vuan efektet e pandemisë. Por ndryshe nga shumë shtete të tjera që specifikisht personat me sindromën Down (shkencërisht të konsideruar si grup me risk të lartë), i kanë futur në grupet prioritare (1 ose 2) për vaksinim, plani i vaksinimit në Shqipëri nuk i përmend fare as personat me sindromën Down, dhe as PAK si target grup. Ky plan po ashtu nuk ka përfshirë as profesionistët që punojnë si ofrues shërbimesh të PAK.

Qeveria shqiptare në 2020, për të lehtësuar vështirësitë e karantinës dhe të pandemisë, mbështeti me pagesa “cash” si dhe me pako ushqimore familjet në skemën e ndihmës ekonomike, por deri më sot nuk ka mbështetur në asnjë formë PAK.

6. MJAFT MË ME NARRATIVA DISKRIMINUESE DHE SHARJE MES POLITIKANËSH DUKE PËRDORUR DIAGNOZA TË PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA INTELEKTUALE

Fondacioni ynë i bën thirrje politikanëve shqiptarë që të ndalojnë menjëherë e përgithmonë narrativat që nxisin bullizmin, diskriminimin, stigmën, stereotipet si dhe dhunen psikologjike e fizike. Mjaft më! Jeni duke shkelur rëndë etikën në komunikim e keni kaluar çdo cak të një morali të shëndetshëm shoqëror!

7. PARTITË POLITIKE KRYESORE TË PËRFSHIJNË KONKRETISHT NË PROGRAMET E TYRE ELEKTORALE PËR ZGJEDHJET E 25 PRILL 2021 ÇËSHTJE DHE PRIORITETE PER PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA.

Organizatat më aktive në nivel kombëtar dhe vendor, që punojnë për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara dhe familjeve të tyre, kanë identifikuar dhe duan t’u sjellin në vëmendje të të gjitha partive politike nevojën për ndërhyrje në platformat e tyre elektorale dhe programet e qeverisë së ardhëshme, në disa nga fushat kryesore, të domosdoshme për të garantuar, barazinë, mosdiskriminimin dhe përfshirjen sociale të personave me aftësi të kufizuara në Shqipëri:

1. Arsim cilësor gjithpërfshirës për fëmijët me aftësi të kufizuara;
2. Shërbime shoqërore dhe shëndetësore cilësore dhe të aksesueshme për personat me aftësi të kufizuara, përfshirë në situatën e krijuar nga covid-19;



**Down Syndrome  
Albania**

3. Aksesueshmëri në mjedise, transport, informim dhe komunikim për personat me aftësi të kufizuara të të gjithë grupeve, përfshirë personat me aftësi të kufizuara fizike, shqisore, personat me probleme në shikim, në të folur dhe dëgjim dhe aftësi të kufizuara intelektuale;
4. Aftësim dhe riaftësim/rehabilitim profesional, punësim e shërbime mbështetëse për punësimin e personave me aftësi të kufizuara;
5. Pjesëmarrje në jetën politike dhe publike, përmes garantimit të pjesëmarrjes në votime, por edhe në proceset vendimmarrëse në të gjitha nivelet;

**Disa propozime specifike për premtime dhe përfshirje në programe të partive që Fondacioni ynë kërkon të konsiderohen nga partitë kryesore politike në vend janë:**

- Ndarja e cështjeve të PAK nga Ministria e Shëndetësisë (bashkimi i dy ministrive nuk ka qënë efiçent për t'i dhënë vëmendjen e duhur personave me aftësi të kufizuara).
  - Planifikimimi dhe kostimi i shërbimeve për të gjitha grupet dhe përgjatë të gjithë ciklit të jetës për personat me aftësi të kufizuara, parashikimi i buxheteve për ngritjen e tyre në nivel lokal si dhe hartimi i standardeve për çdo shërbim të parashikuar në ligjin shqiptar për shërbimet shoqërore (2016).
  - Planifikimi i buxheteve për të garantuar qëndrueshmërinë e shërbimeve ekzistuese që ofrohen nga organizatat e PAK, me të paktën 30% të buxhetit vjetor të tyre.
  - Leja e lindjes së nënave që lindin fëmijë me aftësi të kufizuara apo që diagnostikohen brenda vitit të parë të jetës, të jetë 3 vjeçare.
  - Futja e të paktën shërbimeve si logopedia dhe fizioterapia në skemë si shërbime të rimbursueshme (si barnat) me të paktën 50% të vlerës që prindërit dhe PAK paguajnë privatisht dhe nuk i aksesojnë dot si shërbime publike.
  - Ofrimi i lehtësirave të tjera për sektorin jo-publik të shërbimeve (tarifë preferenciale ose rimbursim të energjisë elektrike (aktualisht paguajmë me tarifë biznesi); tarifë preferenciale ose heqje detyrimi për taksën mbi pronën, për taksat e tjera lokale etj; rimbursim i të paktën kostove të punëdhënësit për sigurimet shëndetësore dhe shoqërore të stafeve të shërbimeve terapeutike (terapistët).
  - Hartimi i një ligji të ri për Sponsorizimet, Dhurimet dhe Filantropinë, që të rrisë incentivat fiskale për bizneset dhe të shtojë dhe incentiva fiskale për dhuruesit individualë.
  - Aplikimi nga institucione të qeverisjes qendrore (ministritë) i skemave të grantdhënies për organizatat e personave me aftësi të kufizuara.
  - Statistika të sakta dhe të integruara për PAK në Shqipëri
- 

Në link gjeni mesazhet e Ambasadorit të Delegacionit Evropian, Z.Luigi Soreca dhe të Ambasadorit të Prezencës së OSCE në Shqipëri Z. Vincenzo Del Monaco për 21 Marsin: <https://we.tl/t-qMIYwjc97g>



Down Syndrome  
Albania

Në kuadër të 21 Marsit, Fondacioni Down Syndrome Albania risjell **ekspozitën “Edhe Unë Jam Një Vepër Arti” – të fotografes Soela Zani**. Ekspozita mund të vizitohet gjatë datave 24-27 Mars tek Kalaja e Tiranës.

**Ekspozitë / Exhibition**  
**EDHE UNË JAM NJË VEPËR ARTI**  
/ Every Human Is A Piece Of Art!

**21 Marsi**  
Dita Botërore e Sindromës Down

**ids**

**24.03 - 27.03 / 2021**  
Tek Kalaja e Tiranës

Këtë vit kauzës sonë për ndërgjegjësime i është bashkuar dhe Federata Shqiptare e Futbollit, Ekipi Ynë Kombëtar.

**Today we stand for**  
**FAIR PLAY = FAIR AND EQUAL**  
**OPPORTUNITIES!**

**21st of March**  
**World Down Syndrome Day**

Fondacioni ynë i është shumë mirënjohës medias dhe gazetarëve që ndër vite na ka ndihmuar të ndërgjegjësojmë e ngremë zërin për të drejtat e personave me sindromën Down në Shqipëri.

Me respekt,

Fondacioni Down Syndrome Albania

[www.dsalbania.org](http://www.dsalbania.org)

+355693443345 (Mirela Juka, Person Kontakti)